

VENDIM
Nr. 418, datë 15.5.2013

**PËR RRRITJEN E AKSIONEVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KAPITALIN E BANKËS SË
DETIT TË ZI PËR TREGTI DHE ZHVILLIM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 7969, datë 20.7.1995 “Për ratifikimin e marrëveshjes për krijimin e Bankës së Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim” dhe të nenit 2 të ligjit nr. 113/2013 “Për aderimin në rezolutën e bordit të guvernatorëve të Bankës së Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim (BSTDB)”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Aksionet e Republikës së Shqipërisë në kapitalin e Bankës së Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim rriten për shumën 20 (njëzet) milionë SDR, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 113/2013 “Për aderimin në rezolutën e bordit të guvernatorëve të Bankës së Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim (BSTDB)”.

2. Autorizimin e Ministrisë së Financave të kryejë të gjitha procedurat e nevojshme për realizimin e shtesës së aksioneve në kapitalin e Bankës së Detit të Zi për Tregti dhe Zhvillim, sipas pikës 1 të këtij vendimi, nga të cilat 30% do të paguhet në lekë (e barasvlershme me shumën 6 (gjashtë) milionë SDR) dhe 70% me notë premtimi. Paga prej 6 (gjashtë) milionë SDR do të bëhet nga Buxheti i Shtetit, sipas skedulit të mëposhtëm:

Viti 2013	500 mijë	SDR
Viti 2014	1 milion	SDR
Viti 2015	1 milion	SDR
Viti 2016	1 milion	SDR
Viti 2017	1 milion	SDR
Viti 2018	1.5 milionë	SDR

3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha